



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Zyra e kryetarit të Komunës

Klinë, 09.02.2026

Nr. 06-4190/26

PROCESVERBAL

Nga takimi I dytë I kryetarit të Komunës me qytetarë, mbajtur në sallën e Kuvendit në orën 10:00 me datë 23 dhjetor 2025.

Pjesëmarrës : Kryetari I Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetari z. Fadil Gashi, kryesuesi I kuvendit, z. Enver Berisha, qytetarë, media.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Përshëndetje të gjithëve. Ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë takim. Është I dyti për këtë vit që organizohet me qytetarë dhe më lejoni që në pika të shkurtër të bëjë një prezantim të shkurtër lidhur me të gjitha të arritura të kësaj periudhe menaxhuese. Unë do të filloj me disa të dhëna, numra në mënyrë telegrafike. Buxheti për vitin 2025 ka qenë I aprovuar në vlerë prej 16 milion e 474 mijë e 17 cent. Prej tyre janë shpenzuar deri dje 15 milion e 615 mijë e 212 euro. Mjetet e pa shpenzuara janë 850 mijë. Në përqindje I bije 94.79%, kjo vlerë e shpenzimit është deri dje që I kemi edhe tre, katër ditë. Duke e pasur parasysh fatin e zhvillimit të projekteve krahasuar me vitet e tjera është një realizim shumë I mirë dhe jashtëzakonisht e rëndësishme. Sipas kodeve, për shpenzime kapitale janë shpenzuar 91.8%, kushti minimal për të qenë të shpërblyer me fondin e performancës është 70% që d. m.th jemi në nivel të kënaqshëm. Kategoria ekonomike, mallra dhe shërbime janë shpenzuar 91.36%, në Subvencione dhe transfere janë shpenzuar 76.02% deri dje por që këto dy tre ditë do të rritet kjo përqindje. Nga shpenzimet komunale janë shpenzuar nga buxheti I paraparë 96.77%. Këto janë disa nga vlerat të cilat në aspektin financiar dëshmojnë për një vit jashtëzakonisht të suksesshme në shërbim të qytetarëve. Këtë vit kemi pasur edhe zgjedhje lokale e si rrjedhojë kanë dalur edhe organet e reja ku unë shfrytëzoj rastin që të I uroj shëndet e sukses kryesuesit të zgjedhur Enver Berisha dhe nënkryetarit të komunës, z. Fadil Gashi. Sigurisht deri nga fundi I vitit ose fillimi I vitit të ardhshëm do të kompletohet kabineti. Duke e pasur parasysh të gjitha këto shpenzime buxhetore të bëra gjatë vitit 2025 mund të listoj disa nga projektet e suksesshme që është transiti I qytetit I cili projekt ka nisur tash një vit ku gjatë vitit 2025 gjysma e projektit është realizuar me sukses, pengesa kanë qenë shpronësimet që ka qenë marrëveshje me ministrinë. Ne komuna kemi hartuar elaboratin e shpronësimit dhe që të premten e kaluar është marrë vendimi preliminar nga ana e qeverisë për shpronësim. Ky hap do të ndihmoj që projekti nga fundi I vitit 2026 të përfundoj. Deri tani është punuar vetëm në pjesët e rrugëve ku kanë qenë pronë publike apo marrëveshje me pronar. Një projekt tjetër shumë I rëndësishëm por

që ende nuk është parë sa duhet është edhe finalizimi I fundërruesit për ujë të pijshëm. Gjatë vitit 2024 dhe mesi I vitit 2025 është përfunduar me sukses. Ky Projekt merr ujin nga “Drini i bardhë” dhe e pastron fizikisht. Qëllimi I këtij projekti është arritur dhe ne kemi burim të mjaftueshëm për qytetin e Klinës. Ky projekt në një farë forme merret uji nga fundërruesi kalon nëpërmjet fabrikës ku fabrikës ju kanë ndërruar filtrat. Dua të ju informoj që komunikimi i fundërruesit me fabrikën nuk është edhe aq efikas por që këtë zgjidhje do ta gjejmë përmes hartimit të projektit përkatës. Pengesë kryesor gjatë vitit 2025 ka qenë se Republika e jonë nuk ka pasur qeveri me vendim marrje të plotë. Komuna është vështirë me buxhetin e vet rreth 4.5 milion euro në vit të bëjë projekte me rendësi të tilla. Projekt tjetër është ai I shtëpisë së të moshuarve që ka përfunduar dhe është bërë pranimit teknik. Besoj që shumë shpejt do të fillojnë procedurat për pranimin e banorëve të parë. Kemi bërë pranimin e stafit, kemi edhe buxhetin e ndarë dhe që nga fillimi I vitit të ardhshëm do të fillojmë funksionalizimin. Afër objektit të të moshuarve, kemi bërë marrëveshje mirëkuptimi me një fondacion të Katarit për ndërtimin e një objekti për urgjencë dhe QMF. Këto objekte janë në pjesën e Dollcit. I njëjti fondacion I Katarit ka filluar të sjell pajisjet për ndërtimin e një objekti për personat me aftësi të kufizuara. Do të shohim modalitete që edhe pushteti lokal edhe qendror të merr përsipër përkujdesjen për këtë kategori. Besoj shumë shpejt do të ndërtohet objekti I tillë dhe do të na duhet një bashkëpunim me nivelin qendror. Kemi punuar në infrastrukturë rrugore ku afërsisht 95% të rrugëve janë ndërtuar. Kemi problem me pronësi dhe pak jemi mbrapa por kemi buxhet të mjaftueshëm që ta realizojmë edhe rrugën e Dresnikut por që vitin e ardhshëm do ta realizojmë. Në qytet kemi future në buxhetin e vitit 2026 të gjitha rrugët. Rruga “Mal Bashota” është buxhetuar por edhe aty kemi nga pak problem me shpronësim. Jam ndalë pak në kohë të zgjedhjeve sepse ajo periudhë ma kufizon aktivitetin e shpronësimit por që tash do të nis menjëherë. Rruga e “Heronjtë e Kombit”, rruga “Shaban Polluzha”, rruga “Vëllezërit Gërvalla”, rruga “Bedri Mustafa” janë të gjitha këto rrugë që do të bëhen me standard të larta e që nënkupton: Infrastrukturë nëntokësore- kanalizime, kablo nëntokë, 6 metra gjerësi, trotuare dy anësor, ndriçim etj. Kemi pasur investime të konsiderueshme nëpër shkolla, I kemi mirëmbajtur, rregulluar dhe bërë investime kapitale të rëndësishme nëpër shkolla si ato të ngrohjes qendrore me pompa termike. Drejtoria e financave na njofton që shpenzimet janë shumë më të vogla sa I përket ngrohjes dhe ftohjes. Edhe në QKMF janë bërë investime të tilla nga djegiet me naftë në pompa termike si dhe shumë shkolla të tjera në fshatra. Ky projekt do të vazhdojë vitin e ardhshëm edhe në investime në eficientë. Kemi vazhduar me procesin e ngritjes së nivelit të rrugëve. Po I sanojmë aty ku ka gropa dhe po finalizojmë rrugët për Volljak dhe Sferkë si dhe për Shtupel. Do të vazhdojmë me investime të tilla ku për vitin e ardhshëm kemi planifikuar zonat Jelloc- Resnik pastaj Leskoc etj. ku do të rehabilitohen me shtrimin e një shtrese asfalti të ri. Një nga projektet e rëndësishme është edhe projekti I trajtimit të ujërave të zeza, projekt që si komune nuk mund ta mbështesim shkaku I vlerës së madhe financiare e që duhet gjithsesi dora e nivelit qendror. Kemi hartuar projektin e fizibilitetit e vitin e ardhshëm do ta hartojmë projektin teknik që do të na jep koston e nevojshëm për ndërtim. Për fshatrat ku nuk mund të komunikojnë me impiantin qendror ne kemi filluar të ndërtojmë impiante biologjike. Nga rruga Pejë- Prishtinë deri tek fshati Krushevë e vogël, në të dy anët e lumit do të ndërtohen bankina dhe infrastrukturë të nevojshme. Jemi në fazën e nënshkrimit të kontratave dhe është në 5 loto ku do të ndërtohet një gyp për bartje të ujërave të zeza dhe do të barten përmes tij në pjesën jugore të qytetit që së paku edhe qyteti vet të jetë I

mbrojtur nga ujërat e zeza. Ky projekt nuk und të realizohet me një buxhet komunal prandaj planifikohet që të ketë përkrahje nga qeveria.

Shfrytëzoj rastin që të ju uroj të gjithë mërgimtarëve që kanë ardhur , pushim dhe çmallje me familjen.

Nuk kisha me e zgjatë më shumë. U mundova që të jap një informim për zhvillimin që kemi pasur. Kemi punuar me transparencë prandaj jemi shpërblyer me 100 poenë, jemi komuna me transparente në Kosovë. Jemi gjithsejtë 5 komuna që kemi fituar Grandin dhe nuk dimë se sa mjetet do të na ndahen. Varet shumë nga 4 komunat e tjera kush ka fituar sepse kjo ndarje bëhet bazuar në numrin e banorëve. Do të vazhdojmë të punojmë dhe të mundohemi të përmirësojmë jetën e qytetarëve.

Nëse dikush ka ndonjë pyetje ju lutem që të prezantoheni shkaku I procesverbalit.

Pavarësisht se salla ishte e mbushur me qytetarë të komunës së Klinës, asnjëri nga të pranishmit nuk e morri fjalën, kështu që kryetari I komunës, z. Elezaj e shpalli të mbyllur këtë takim duke I uruar të gjithë për festat e fund vitit.

Procesmbajtës:
Skënder Behramaj

Kryetari i Komunës
Zenun Elezaj

